# Pontes

N. 4
05 / 2019



Pubblicato dalla
**Fondazione Nostra Signora del Buon Consiglio**

A cura di:
Padre Daniele **Bertoldi**
Presidente della Fondazione
Nostra Signora del Buon Consiglio

Prof. Bruno **Giardina**
Magnifico Rettore dell'Università Cattolica
"Nostra Signora del Buon Consiglio"

Da un'idea di // Një ide nga:
dott.ssa Daniela **Kostandini**
dott.ssa Diana **Hila**
dott.ssa Elva **Margariti**
dott.ssa Enilsa **Magjistari**

Grafica di // Përpunimi grafik
Fredi **Dragusha (grafplus)**

Botim i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë

Nën kujdesin e:
Atë Daniele **Bertoldi**
President i Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë

Prof. Bruno **Giardina**
Rektor i Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"

Contattateci// Na kontaktoni
pontes@unizkm.al

# sommario
# përmbajtja

**04**
Editoriale //
Editorial

**06**
Il ragazzo di Harvard //
Djali i Harvardit

**08**
Ospedale “Nostra Signora del Buon Consiglio”//
Spitali “Zoja e Këshillit të Mirë”

**10**
Missione Africa

**13**
ALUMNI

**16**
Festa della Fondazione //
Festa e Fondacionit

**20**
Erasmus

**32**
Progetti Architettura
Projektet e Arkitekturës

**42**
Consiglio Studenti //
Këshilli i Studentëve

**46**
Eventi // Evente

# LA SPERANZA: UNA VIRTÙ IN CRISI

Secondo Christopher Lasch (The True and Only Heaven), la speranza si distingue dall'idea chiave dell'Illuminismo, l'idea di un progresso infinito, grazie allo sviluppo della scienza e alla maturazione della ragione. Ma la speranza implica una fiducia nella vita che sembrerebbe assurda a coloro a cui manca; una fiducia basata sul passato, ma apre la strada verso il futuro.

Il Rabbi Jonathan Sacks (The Dignity of Difference), riflettendo sulla storia del suo popolo, dice che ha imparato a distinguere tra ottimismo e speranza. "Ottimismo" vuol dire credere che le cose possono migliorare. "Speranza" vuol dire credere che, insieme, possiamo migliorare le cose. L'ottimismo è una virtù passiva, la speranza è una virtù positiva. L'ottimismo dominava gli ultimi decenni del secolo 19. Ma questo ottimismo si è confrontato con le atrocità del secolo 20. Le due guerre mondiali, Hiroshima, e l'olocausto nella prima metà del secolo 20, e, nella seconda metà, i genocidi come quelli nel Burundi e nei Balcani, bastano per vedere che quell'ottimismo non era che un sogno. La diffusione del pluralismo e la caduta del comunismo nel 1989 portavano nuove speranze. Dopo la caduta del comunismo, Francis Fukuyama, nel suo articolo "The End of History", scrive che l'etica del consumo scioglie i conflitti ideologici. Il futuro sarà oscuro, ma pacifico. Aveva ragione o no? Il pluralismo ci dava speranza per una convivenza pacifica pluri-culturale e pluri-razziale. Invece, sono sorte nuove forme di tensioni razziali e di intolleranze.

Nei primi anni di questo millennio, abbiamo visto nuovi e tragici fenomeni di terrorismo. Basti ricordare 11 settembre 2001! Le guerre nell'Afghanistan e nell'Iraq, erano intenzionate a frenare il terrorismo. Ma di fatto l'hanno fomentato di più! Tutto questo non ha lasciato posto a utopie.

M. Rutter e D. Smith, autori di Psychosocial Disorders in Young People (1995), vedono un grosso aumento di casi di depressione, disordini psico-sociali, droghe, alcoolismo, e suicidi tra i giovani. J. Sacks (The Politics of Hope) osserva che gli anni 60 erano descritti come la "morte di Dio"; ma gli anni 90 sembravano più come la morte dell'ottimismo.

Questa situazione, ha aperto la strada alla cultura della disperazione. Aveva ragione Papa Paolo VI, il quale, nella enciclica Populorum Progressio, affermava che l'uomo può organizzare la terra senza Dio, "ma senza Dio egli non può che organizzarla contro l'uomo. L'umanesimo esclusivo è un umanesimo inumano".



**Monsignor George Frendo**
Arcivescovo Metropolita di Tirana - Durazzo //
Arqipeshkëv Metropolit Tiranë - Durrës

# SHPRESA: NJË VIRTYT NË KRIZË

EDITORIAL

Sipas Christopher Lasch (The True and Only Heaven), shpresa dallon nga ideja kryesore e Iluminizmit, ideja e një zhvillimi të pafund, falë zhvillimit të shkencës dhe pjekjes së arsyes. Por shpresa nënkupton besimin tek jeta, që do të dukej absurde, për ata që nuk e kanë; një besim i bazuar në të kaluarën, por që hap rrugën drejt së ardhmes.
Rabini Jonathan Sacks (The Dignity of Difference), duke reflektuar mbi historinë e popullit të tij, thotë se ka mësuar të bëjë dallimin mes optimizmit dhe shpresës. "Optimizëm" do të thotë të besosh se gjërat mund të përmirësohen. "Shpresë" do të thotë të besosh se, së bashku mund të përmirësojmë gjërat. Optimizmi është një virtyt pasiv, shpresa është një virtyt pozitiv.
Optimizmi mbizotëronte dekadat e fundit të shekullit 19. Por ky optimizëm u përball me mizoritë e shekullit 20. Dy luftërat botërore, Hiroshima dhe holokausti në gjysmën e parë të shekullit të 20-të, dhe në gjysmën e dytë, gjenocidet si ato në Burundi dhe Ballkan, janë të mjaftueshme për të parë, se ai optimizëm ishte vetëm një ëndërr.
Përhapja e pluralizmit dhe rënia e komunizmit në vitin 1989 solli shpresë të re. Pas rënies së komunizmit, Francis Fukuyama, në artikullin e tij "The End of History", shkruan se etika e konsumatorit shpërbën konfliktet ideologjike. E ardhmja do të jetë e errët, por paqësore. A kishte të drejtë apo jo? Pluralizmi na jepte shpresë, për një bashkëjetesë paqësore multi-kulturore dhe multi-racore. Në vend të kësaj, u krijuan forma të reja tensionesh racore dhe mostolerancë.
Në vitet e para të këtij mijëvjeçari, pamë fenomenet e reja dhe tragjike të terrorizmit. Mjafton të kujtojmë 11 shtatorin e vitit 2001! Luftërat në Afganistan dhe Irak, kishin për qëllim të frenonin terrorizmin. Por në fakt ato e kanë ushqyer më shumë! E gjithë kjo nuk la hapësirë për utopi.

M. Rutter dhe D. Smith, autorë të Psychosocial Disorders in Young People (1995), shohin një rritje të madhe të rasteve të depresionit, çrregullimeve psiko-sociale, drogës, alkoolizmit dhe vetëvrasjeve tek të rinjtë. J. Sacks (The Politics of Hope) vëren se vitet 60 përshkruheshin si "vdekja e Zotit"; por vitet '90 dukeshin më shumë si vdekja e optimizmit.
Kjo situatë i ka lënë shteg përhapjes së kulturës së dëshpërimit. Papa Pali VI kishte të drejtë kur, në Enciklikën Populorum Progressio, pohonte se njeriu mund të organizojë tokën pa Perëndinë", por "pa Perëndinë ai mund t'a organizojë, vetëm kundër njeriut. Humanizmi ekskluziv është një humanizëm çnjerëzor".

# Il ragazzo di **HARVARD**




La perseveranza lo trasforma, e l'università forma e prepara l'individuo per il futuro. L'eccellenza dei laureati della Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" ti apre anche le porte della più prestigiosa università del mondo, Harvard.

È questo il caso di Lorenc Konomi, prima generazione di laureati della Facoltà di Medicina dell'UCNSBC, che sta svolgendo un Post Dottorato alla Harvard Medical School, e al tempo stesso ricopre la posizione di Assistente del Prof. Assoc. Efi Kokkotou.
Per la rivista Pontes, Lorenc ci racconta la sensazione di essere parte della UCNSBC.

*"Alla UCNSBC ho appreso le basi della professione e questo gioca un ruolo essenziale nell'inquadramento della mia figura professionale. Grazie ai professori e alle strutture universitarie (biblioteca e campus), di livelli europei, è stato possibile per noi ALUMNI UCNSBC, raggiungere un alto livello di pensiero analitico e formazione professionale, senza mai sentirsi da parte, dagli studenti e professionisti europei e americani .*

*Il diploma europeo rilasciato dalla UCNSBC ha facilitato l'attraversamento dei confini balcanici, consentendoci di entrare nel mercato internazionale del lavoro. Il mio caso ne è la prova concreta. Ho esercitato la professione di medico e chirurgo in Italia per più di 7 anni. È facilmente verificabile che gli studenti UCNSBC sono sollecitati da cliniche italiane e tedesche (dove il mercato del lavoro è attualmente direzionato), poiché la loro formazione è una garanzia per ogni direttore dipartimentale o personale medico in queste cliniche".*

Presso l'UCNSBC, Lorenc Konomi ha anche completato il dottorato di ricerca in "Sanità Pubblica, Diagnosi Molecolare delle Malattie Infettive e Farmacovigilanza", dal 2013 al 2017.
Alla Harvard Medical School, Lorenc Konomi insegna e fa ricerca scientifica. Il suo lavoro scientifico si basa su due ricerche di livello internazionale: 1) Melanin-Concentrating Hormone (MCH) as a mediator of intestinal inflammation; 2) Role of Substance P in feeding behavior and metabolism.

# Djali i **HARVARDIT**

ALUMNI



Këmbëngulja e transformon, dhe universiteti e formon dhe e përgatit njeriun për të ardhmen. Ekselencës së të diplomuarëve të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" i janë hapur edhte dyert e universitetit më prestigjoz në botë, atij të Harvardit.
Ky është rasti i Lorenc Konomit, brezi i parë i të diplomuarëve në Fakultetin e Mjekësisë së UKZKM, i cili po kryen Post Doktoratën në Harvard Medical School, dhe njëkohësisht mban pozicionin e asistentit të Prof. Asoc. Efi Kokkotou. Për revistën Pontes, Lorenci tregon çdo të thotë që të jesh pjesë e UKZKM.

"*Në UKZKM kam marrë bazat e profesionit dhe kjo luan një rol thelbësor në plotësimin e figurës time profesionale. Falë profesorëve dhe strukturës universitare (biblioteka dhe kampusi), të nivelit europian është bërë e mundur që ne, ish studentët e UKZKM të arrijmë një nivel të lartë mendimi analitik dhe formimi profesional, duke mos u ndjerë asnjë çast pas nga studentët dhe profesionistët europianë dhe amerikanë.*

*Diploma europiane që UKZKM lëshon ka lehtësuar kalimin e kufijve ballkanikë, duke na lejuar hyrjen në tregun ndërkombëtar të punës. Rasti im është prova konkrete. Unë kam ushtruar profesionin tim si mjek dhe kirurg në Ital,i për më shumë se 7 vite. Është lehtësisht e verifikueshme se, studentët e UKZKM kërkohen me ngulm nga klinikat italiane dhe gjermane (ku aktualisht po drejtohet më shumë tregu i punës), pasi formimi i tyre është garanci për këdo drejtues departamenti apo personel mjekësor në këto klinika*".
Në Universitetin Katolik ZKM, Lorenc Konomi ka kryer gjithashtu edhe ciklin e studimeve doktorale në "Shëndet Publik, Diagnozë Molekulare të Sëmundjeve Infektive dhe Farmakovigjilancë" nga viti 2013 - 2017.
Në Harvard Medical School, Lorenc Konomi kryen mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Puna e tij shkencore bazohet në dy fusha kërkimi të nivelit ndërkombëtar. 1) Melanin-Concentrating Hormone (MCH) as a mediator of intestinal inflammation; 2) Role of Substance P in feeding behavior and metabolism.

# OSPEDALE

## "NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO"



Il Segretario di Stato della Città del Vaticano, Sua Eminenza, Cardinal Pietro Parolin, ha inaugurato a Tirana il 25 febbraio 2019 i lavori in corso dell'Ospedale "Nostra Signora del Buon Consiglio" in costruzione entro il Campus Universitario.

Il nuovo e moderno Complesso dell'Ospedale fungerà quale centro diagnostico, di benessere e terapeutico, ma anche quale punto importante di riferimento per l'Albania.

La nuova struttura sarà operativa tra 18 mesi e l'Albania verrà arricchita dell'unica struttura ospedaliera privata, con un centro di ricerca dai parametri internazionali.

Presenti alla cerimonia di Benedizione della Prima Pietra presieduta dal Cardinal Pietro Parolin erano il Presidente della Repubblica, Sua Eccellenza Ilir Meta, e numerose personalità importanti locali ed internazionali del mondo politico, governativo, diplomatico e accademico, sia locale che internazionale.



# SPITALI

## "ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË"

Sekretari i Shtetit të Vatikanit, Eminenca e Tij, Kardinali Pietro Parolin, përuroi në Tiranë më 25 shkurt 2019, punimet e Spitalit "Zoja e Këshillit të Mirë", që po ndërtohet brenda kampusit universitar. Kompleksi i ri dhe modern i Spitalit do të shërbejë si qendër diagnostikuese, mirëqenie dhe terapeutike, duke u kthyer në një pikë referimi për Shqipërinë. Punimet pritet të përfundojnë pas 18 muajsh dhe Shqipëria do të pasurohet me të vetmen strukturë spitalore private, që do të ketë një qendër kërkimore të parametrave ndërkombëtarë.

Ceremonia e Bekimit të Gurit të Parë nga Kardinali Pietro Parolin u përcoll nga kreu i shtetit shqiptar, Shkëlqesia e Tij Ilir Meta, si dhe personalitete të rëndësishme në vend si përfaqësues të qeverisë, politikës, trupit diplomatik dhe botës akademike.

# MISSIONE "AFRICA"



Ina Levanaj e Dario Bello, studenti della Facoltà di Medicina dell'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" hanno scelto il continente africano, per la ricerca della tesi di laurea. Nella Costa d'Avorio, loro stanno preparando il tema intitolato "Il ruolo della malnutrizione nelle ernie ombelicali dei bambini africani nel primo anno di nascita".

In questo periodo, Ina e Dario conducono anche la vaccinazione dei bambini, presso il Centro Comunitario "Mère Maria Elisa Andreoli" a Cocody, Abidjan.

# MISIONI “AFRIKË”



Ina Levanaj dhe Dario Bello, studentë të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" zgjodhën kontinentin afrikan për të zhvilluar temën e diplomës. Në Bregun e Fildishtë, ata po përgatisin temën e titulluar: "Roli i kequshqyerjes në hernien ombelikale tek fëmijët afrikanë në vitin e parë të lindjes".
Në këtë periudhë, Ina dhe Dario po kryejnë edhe vaksinimin e fëmijëve pranë Qendrës Komunitare "Mère Maria Elisa Andreoli" në Cocody, Abidjan.





L'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" assiste e si prende cura degli studenti e dei laureati, non solo con le pratiche professionali, ma anche nel mondo del lavoro.

Bledar Shapa si è laureato nel Programma di Studi in Infermieristica, presso l'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio", nella sede di Elbasan (anno accademico 2006 - 2009). Presso la sede di Elbasan, ricopre il ruolo di Coordinatore del Praticantato degli studenti.

Per Pontes, Bledar parla delle sue esperienze come studente, e poi come parte dello staff della UCNSBC.

*"Con estremo piacere, posso dire che non avrei potuto scegliere di meglio. Ho avuto l'opportunità di esperienze uniche, nel reparto di traumatologia-ortopedia presso l'ospedale Carlo Poma di Mantova e nella struttura del CRA a Bologna, in Italia. Ho acquisito varie esperienze in strutture sanitarie, grazie alla formazione ottenuta presso l'UCNSBC. Dal luglio 2018 sono tornato in Albania, dove sono cresciuto professionalmente. Con molta umiltà e affetto, esprimo la mia gratitudine ai professori e a tutto lo staff della UCNSBC."*



# FUTURO DA INFERMIERE // E ARDHMJA E INFERMIERIT

Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" ndjek dhe kujdeset për studentët dhe të diplomuarit, jo vetëm me praktikat profesionale, por edhe me hapjen e dyerve të karrierës.

Bledar Shapa u diplomua në Programin e Studimit në Infermieri, pranë Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", në selinë e Elbasanit (viti akademik 2006 - 2009). Po në selinë e Elbasanit, ai mban sot rolin e Koordinatorit të Praktikave të studentëve.

Për Pontes, Bledari tregon eksperiencat e tij si student, dhe më pas si pjesë e stafit të UKZKM.

*"Me bindje dhe kënaqësi, mund të them që nuk do të mund të kisha zgjedhur më mirë. Kam pasur mundësinë unike të eksperiencës, në repartin e ortopedi-traumatologjisë në Spitalin "Carlo Poma" në Mantova dhe në strukturën CRA, në Bolonja të Italisë. Kam arritur të përfitoj eksperienca në struktura shëndetësore të ndryshme, falë formimit të marrë në UKZKM. Prej korrikut 2018 jam kthyer në Shqipëri, në vendin ku u rrita profesionalisht. Me shumë përulje dhe dashuri, shpreh mirënjohjen time ndaj profesorëve dhe gjithë stafit të UKZKM."*

Oltjon Isaj, oggi fisioterapista della Squadra albanese della Superliga, Flamurtari.

*"Grazie al programma di Studio in Fisioterapia, sia nella parte teorica che quella pratica, fattori importantissimi in questa professione, mi sono da subito sentito a mio agio, con il lavoro nella squadra".*

Oltjon ha iniziato a lavorale subito dopo la laurea, nel maggio 2015. Durante il periodo 2011-2014, ha frequentato il Programma di Studio in Fisioterapia, presso l'UCNSBC.



Oltjon Isaj, sot është fizioterapist i Klubit shqiptar të Superligës, Flamurtarit.

*"Falë Programit të Studimit në Fizioterapi, si në pjesën teorike, ashtu edhe në atë praktike, faktorë shumë të rëndësishëm në këtë profesion, u përshtata shumë shpejt me punën në ekip".*

Ushtrimin e profesionit Oltjoni e nisi në maj të vitit 2015, pas diplomimit. Gjatë viteve 2011 - 2014, ai ndoqi Programin e Studimit në Fizioterapi në UKZKM.



# **FISIOTERAPIA: STORIE DI SUCCESSO //**
# FIZIOTERAPIA: HISTORI SUKSESI



Luca Zampa, italo-albanese, assunto come fisioterapista nella squadra giovanile della Lazio, subito dopo la laurea presso l'UCNSBC.

*"Sono felice di avere seguito i studi presso l'UCNSBC. Subito dopo la laurea, ho iniziato a lavorare come fisioterapista a Roma, con i campioni di calcio della U-19 (Primavera) della Lazio."*

Luca ha completato gli studi nel Programma di Fisioterapia alla UCNSBC, dal 2014-2017.



Luca Zampa, shqiptaro-italian, u punësua si fizioterapist në skuadrën e futbollit të të rinjve të Lazios, menjëherë pas diplomimit në UKZKM.

*"Jam i lumtur që studiova pranë UKZKM. Menjëherë pas diplomimit, kam nisur punën si fizioterapist në Romë, me kampionët e futbollit të kategorisë U-19 (Primavera) të Lazios".*

Luca i kreu studimet në Degën e Fizioterapisë, UKZKM në vitet 2014 - 2017.

# CLINICA ODONTOIATRICA

La Clinica Universitaria Odontoiatrica "Nostra Signora Del Buon Consiglio" è una delle più grandi strutture cliniche a Tirana, che offre servizi odontoiatrici di prim'ordine dal dicembre del 2008. L'équipe di odontoiatri di questa struttura sanitaria è composto da 10 medici odontoiatri, specializzati nelle varie branche odontoiatriche come la conservativa, protesi, ortodonzia, paradontologia, chirurgia maxillo-facciale, ect. Una caratteristica importante di questo centro è che, i medici che ne fanno parte sono tutti laureati presso l'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" ed oltre a medici odontoiatri sono anche docenti o tutor delle rispettive materie, importante questo per garantire un aggiornamento costante, su tutte le nuove tecniche riportate dalla letteratura. Essendo universitaria, tale struttura è divenuta negli anni un punto di appoggio, non solo per i pazienti ma anche per gli studenti che ne costituiscono una parte importante. Il lavoro in team è quello che caratterizza questa clinica, dove ognuno mette a disposizione del paziente le proprie capacità diagnostiche e operative, alla fine di un completo piano di trattamento.



# KLINIKA STOMATOLOGJIKE

Klinika Universitare Stomatologjike "Zoja e Këshillit të Mirë" është një nga qendrat më të mëdha klinike në Tiranë, që ofron shërbime dentare cilësore, prej dhjetorit 2008.
Ekipi i stomatologëve të kësaj qendre shëndetësore përbëhet nga 10 dentistë të specializuar në sektorë të ndryshëm të stomatologjisë, siç janë protezat, ortodontia, paradontologjia, kirurgjia maksilofaciale, etj. Një tipar i rëndësishëm i kësaj qendre është se, mjekët që janë pjesë e saj janë të gjithë të diplomuar në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", dhe përveçse stomatologë, ata janë gjithashtu edhe pedagogë ose tutorë të lëndëve të tyre përkatëse, e rëndësishme kjo, për të siguruar një përditësim të vazhdueshëm, me të gjitha teknikat e reja të literaturës. Duke qenë pjesë e universitetit, kjo strukturë është bërë gjatë viteve një pikë mbështetjeje, jo vetëm për pacientët por edhe për studentët, të cilët përbëjnë një pjesë të rëndësishme të saj. Puna ekipore është ajo që e karakterizon këtë klinikë, ku secili vendos aftësitë diagnostikuese dhe operacionale në dispozicion të pacientit, me qëllim një trajtim të plotë.





# FESTA della Fondazione e Fondacionit




La Festa della Fondazione Nostra Signora del Buon Consiglio si è tenuta il giorno 24 aprile 2019.
Il programma della festa è iniziato con la celebrazione eucaristica dalla Sua Eccellenza Monsignor George Frendo, Arcivescovo Metropolita di Tirana-Durazzo.

La Fondazione ha organizzato un *cocktail* per lo staff, gli invitati e studenti dell'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio". Ha salutato i partecipanti il Presidente della Fondazione, Padre Daniele Bertoldi e sono stati premiati con borse di studio, gli studenti eccellenti dell'Università.

La festa si e animata con il concerto e la performance live delle cantanti: Kejsi Tola, Orgesa Zaimi & Band.




# Aprile Prill 2019

Festa e Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë u zhvillua në datë 24 Prill 2019 në vijim të një tradite të përvitshme. Festa nisi me Kremtimin e Meshës së Shenjtë nga Sh.T. George Frendo, Arqipeshkëv Metropolit Tiranë – Durrës. Më pas, Fondacioni organizoi një *cocktail* për stafin, të ftuarit dhe studentët e Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë".

Me anë të një fjale përshëndetëse iu drejtua të pranishmëve, Presidenti i Fondacionit, Atë Daniele Bertoldi, ndërkohë që studentët e shkëlqyer të Universitetit, u vlerësuan me bursa studimi.

Festa e Fondacionit u ndez me koncertin live, ku interpretuan këngëtaret: Kejsi Tola, Orgesa Zaimi & Band.

# PRESENTAZIONE DEL
# PRESIDE DI ECONOMIA



Dal primo aprile 2019, il Professor Vittorio Teotonico, del Dipartimento di Economia e Finanza dell'Università degli Studi di Bari Aldo Moro, è il nuovo Preside della Facoltà di Scienze economiche, politiche e sociali dell'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" a Tirana.
Egli nel 1993 si è laureato in Giurisprudenza con il massimo dei voti. Nel 1996 ha conseguito sia la Specializzazione in Scienze delle autonomie costituzionaliche l'abilitazione alla professione forense. Nel 2003ha acquisito il titolo di Dottore di ricerca in Diritto pubblico dell'economia.

Dal 2006 insegna Diritto pubblico sia nell'Ateneo pugliese che in quello albanese, presso il quale, altresì, haorganizzato e tenuto diversi convegni e relazioni (in tema, tra l'altro, di "Gestione dei rifiuti", "Lavoro, salute e sicurezza", "Libertà di iniziativa economica e mercato") e ha ricoperto anche vari incarichi di carattere gestionale (Senatore accademico, Membro della Commissione Statuto, Delegato per la Semplificazione delle procedure).

È autore di numerose pubblicazioni di carattere scientifico soprattutto con riguardo al diritto regionale (Referendum consultivo regionale, Sussidiarietà e federalismo fiscale, Potere estero delle Regioni, Autonomie differenziate); poi in materia giuridico-economica (Globalizzazione e Welfare State, Principi di finanza pubblica, Forme di Stato e crisi economica, Rapporti tra costituzionalismo e potere economico); quindi su argomenti di carattere storico-comparato-metodologico (Transizioni costituzionali, Federalizingprocess, Ruolo della scienza giuridica, Lascito di Vittorio Emanuele Orlando nel diritto pubblico).

Fa parte della Redazione dell'Osservatorio costituzionale, Rivista scientifica online dell'Associazione Italiana dei Costituzionalisti, nonché del Comitato editoriale della Collana di Studi di diritto pubblico, diretta da Prof. Francesco Gabriele.
Le sue qualità non solo di studioso ma anche di pratico del diritto (ancora oggi è iscritto all'Albo dell'ordine degli Avvocati di Bari), unitamente alla lunga e varia esperienza maturata al servizio delle istituzioni dell'Università Cattolica Nostra Signora del Buon Consiglio, potranno risultare particolarmente utili nella prosecuzione dell'opera di rilancio della Facoltà attraverso, in particolare, l'aggiornamento e la diversificazione dell'offerta formativa, nonché la massima apertura della medesima Facoltà alle collaborazioni con irappresentanti della realtà politica, sociale e produttiva del territorio albanese.

# PREZANTIMI I **DEKANIT TË EKONOMISË**

Prej 1 prillit 2019, Profesori Vittorio Teotonico, i Departamentit të Ekonomisë dhe Financave të Universitetit të Barit Aldo Moro, është dekani i ri i Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" të Tiranës.
Në vitin 1993 u diplomua në Juridik, me vlersim maksimal. Në vitin 1996 ai përfundoi Specializimin në Shkencat e autonomive kushtetuese si edhe kualifikimin në profesionin ligjor. Në vitin 2003 mori titullin Doktor, në të Drejtën Publike të Ekonomisë.
Prej vitit 2006, ai jep të drejtën publike si në universitetin puljez, ashtu edhe në atë shqiptar, ku ka organizuar dhe mbajtur konferenca dhe raporte të ndryshme (ndër të tjera me temën, "Menaxhimi i Mbeturinave", "Puna, Shëndeti dhe Siguria", "Liria e Iniciativës Ekonomike dhe Tregut") duke mbajtur poste të ndryshme drejtuese (Senator Akademik, Anëtar i Komisionit të Statutit, Delegat për Thjeshtimin e proçedurave).
Ai është autor i botimeve të shumta shkencore, sidomos në lidhje me ligjet rajonale (Referendumi konsultativ rajonal, Subsidiariteti dhe federalizmi fiskal, Fuqia e jashtme e rajoneve, Autonomitë e diferencuara); pastaj në çështjet juridiko-ekonomike (Globalizimi dhe Welfare State, Parimet e financave publike, Format e Shtetit dhe kriza ekonomike, Marrëdhëniet ndërmjet kushtetueshmërisë dhe pushtetit ekonomik); tema të një natyre historiko-krahasuese-metodologjike (Tranzicione kushtetuese, Federalizingprocess, roli i shkencës juridike, trashëgimia e Vittorio Emanuele Orlando në të drejtën publike).
Është pjesë e redaksisë të Observatorit kushtetues, revistë shkencore online e Shoqatës italiane të konstitucionalistëve, si dhe në Komitetit botues të Serive të Studimeve të së drejtës Publike, drejtuar nga Prof. Francesco Gabriele.
Cilësitë e tij, jo vetëm si studiues por edhe si avokat (ende i regjistruar në Dhomën e Avokatisë së Barit), së bashku me përvojën e gjatë dhe të shumëllojshme, e maturuar në shërbimin të insitiucioneve të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", mund të jetë veçanërisht të dobishme, në vazhdimin e punës për rivitalizimin e Fakultetit, në veçanti përmes azhornimit dhe diversifikimit të ofertës formuese, si dhe hapjes maksimale të Fakultetit drejt bashkëpunimeve me përfaqësuesit e realitetit politik, social dhe prodhues, të territorit shqiptar.

# ERASMUS E INTERNAZIONALIZZAZIONE



**Klark Kodra**
Studente Erasmus + //
Student Erasmus +

*A cura di // Nën kujdesin e*
*Prof. Giovanni Lagioia*

L'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" ha una propria intrinseca natura internazionale, tenuto conto delle numerose cooperazioni con prestigiose Università italiane. È così anche nel caso della Facoltà di Scienze Economiche, Politiche e Sociali che sin dal 2004 ha una Convenzione con l'Università di Bari Aldo Moro dove gli studi economici sono stati attivati nel lontano 1886. Questo però non basta e abbiamo potenziato le possibili esperienze internazionali che i nostri studenti possono svolgere attivando accordi di cooperazione nell'ambito del programma Erasmus + con i paesi dell'Unione Europea. Si tratta di un'esperienza formativa importante che ha risvolti positivi in termini di didattica e di crescita personale, migliorando e rendendo più ampie le relazioni sociali, capace di avvicinare gli studenti ai mercati del lavoro e alle imprese internazionali sempre più imperanti nella moderna economia. In Erasmus si cresce molto e una recente analisi della Commissione Europea sull'efficacia di tale programma sottolinea che gli studenti con tale esperienza sono i più occupati a lungo periodo, hanno maggiori capacità di problem solving, sono più curiosi, hanno sviluppato maggiori capacità di adattamento rispetto a giovani che non hanno mai fatto un'esperienza di formazione all'estero. In altri termini si hano migliori prospettive di lavoro e in particolare si tende a sviluppare più facilmente una capacità imprenditoriale. Le aziende lo sanno molto bene e selezionano con più facilità laureati con tali esperienze. Cogli anche tu questa opportunità.

# ERASMUS
# DHE NDËRKOMBËTARIZIMI

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" ka një prirje natyrore drejt ndërkombëtarizimit, duke marrë parasysh bashkëpunimet e shumta me Universitete prestigjioze italiane. Ky është edhe rasti i Fakultetit të Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale, i cili që prej vitit 2004 ka një marrëveshje me Universitetin e Barit Aldo Moro, ku studimet ekonomike janë aktive prej vitit 1886. Megjithatë, kjo nuk është e mjaftueshme dhe ne kemi përforcuar përvojat e mundshme ndërkombëtare që studentët tanë mund të kryejnë, duke aktivizuar marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të programit Erasmus + me vendet e Bashkimit Europian. Kjo është një përvojë e rëndësishme studimore, me implikime pozitive në aspektin e mësimdhënies dhe rritjes personale, duke përmirësuar dhe zgjeruar marrëdhëniet shoqërore, të afta për t'i afruar studentët me tregjet e punës dhe kompani ndërkombëtare, gjithnjë e më dominuese në ekonominë moderne. Në Erasmus ka rritje kapacitetesh dhe një analizë e kohëve të fundit nga Komisioni Europian, mbi efektivitetin e këtij programi thekson se studentët me këtë përvojë, punësohen në afat të gjatë, kanë aftësi më të mëdha për zgjidhjen e problemeve, janë më kuriozë dhe kanë zhvilluar përshtatshmëri më të madhe, krahasuar me të rinjtë që nuk kanë patur një përvojë formuese jashtë vendit. Si përfundim, ekzistojnë perspektiva më të mira punësimi dhe në veçanti ka një prirje për të zhvilluar më lehtë kapacitetet sipërmarrëse. Kompanitë e dinë shumë mirë këtë fakt dhe përzgjedhin më lehtë të diplomuarit me përvoja të tilla. Përfito edhe ti nga kjo mundësi.



# SUMMER SCHOOL 2019

La Summer School "War reconstruction and establishment of Peace from the roots of war to the establishment of a lasting Peace" è arrivata alla sua quarta edizione. Organizzata dal Centro Europeo di Scienza della Pace, Integrazione e Cooperazione (CESPIC) della Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio", in collaborazione con l'Istituto di Economia della Pace e Confronti, si svolgerà dal 29 agosto al 5 settembre di quest'anno a Tirana. Durante questa settimana, docenti e studiosi riconosciuti a livello internazionale forniranno nozioni scientifiche circa le cause della guerra e i vari problemi concernenti la fase di "peacebuilding", ovvero, la ricostruzione di un nuovo assetto politico, economico e sociale che conduca i territori o i Paesi in causa ad una pace duratura. In linea con la tradizione della Scienza della Pace, il programma è interdisciplinare e coinvolge discipline come scienza politica, economia, storia o relazioni internazionali. La Summer School è rivolta a studenti e laureati che hanno un forte interesse per le tematiche legate agli studi di Peace Science e che sono disposti a proseguire gli studi universitari o a diventare futuri professionisti nel campo delle relazioni internazionali e della costruzione della pace.



Summer School "War reconstruction and establishment of Peace from the roots of war to the establishment of a lasting Peace", ka arritur në edicionin e katërt. E organizuar nga Qendra Europiane e Shkencës për Paqe, Integrim dhe Bashkëpunim (CESPIC), të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", në bashkëpunim me Institutin e Ekonomisë dhe Paqes dhe Qendra Confronti, Summer School do të zhvillohet nga 29 gushti deri më 5 shtator 2019, në Tiranë. Gjatë kësaj jave, profesorë dhe studiues të njohur ndërkombëtarë, do të ofrojnë njohuri shkencore mbi shkaqet e luftës dhe problemet e ndryshme në lidhje me fazën e "peacebuilding", që do të thotë rindërtimi i një strukture të re politike, ekonomike dhe shoqërore, që çon territoret ose vendet në fjalë, drejt një paqeje të qëndrueshme. Në përputhje me traditën e Shkencës së Paqes, programi është ndërdisiplinor dhe përfshin disiplina si shkencat politike, ekonomia, historia apo marrëdhëniet ndërkombëtare. Summer School është një ftesë për studentët dhe të diplomuarit, të cilët shfaqin interes për studimet e Peace Science, dhe që janë të gatshëm të ndjekin studimet universitare ose të bëhen profesionistë të ardhshëm, në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe ndërtimit të paqes.



## CENTRO CAMBRIDGE AL008 "NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO"

L'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" dall'anno 2014 è un Centro Autorizzato Cambridge, con una convenzione bilaterale con Cambridge Assessment English, per la somministrazione di tutti i livelli linguistici della Certificazione Cambridge English, dall'A1 al C2. A marzo 2017 il Centro Cambridge "Zoja e Këshillit të Mirë", durante l'ispezione a sorpresa di Cambridge, ha attenuto la valutazione Overall rating: Excellent.
In seguito all'Audit generale da Inspections Coordinator in aprile 2019, il Centro ha attenuto di nuovo la valutazione Overall rating: Excellent.

La Certificazione Cambridge English è riconosciuta in tutto il mondo e non ha una scadenza temporale. Gli esami Cambridge English sono un marchio di eccellenza e aprono le porte nell'ambito accademico e lavorativo.
Un valore aggiunto per coloro che sostengono la Certificazione Cambridge English è la possibilità di passare al livello superiore qualora il candidato risultasse eccellente al livello sostenuto (es: B2 ►C1).
Il nostro Centro Cambridge offre sia il formato paper-based degli esami sia computer-based. A tutti gli interessati offre un pre-testing activity per ogni livello. Le date degli esami sono molto frequenti e con risultati in tempi brevi.Altresì, offre gli standard più alti per la sicurezza del materiale degli esami e la regolarità delle procedure.





## QENDRA CAMBRIDGE AL008 "ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË"

Sipas marrëveshjes dypalëshe me Cambridge Assesment English, Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" që nga viti 2014 është një Qendër e Autorizuar Cambridge për administrimin e të gjitha niveleve gjuhësore të Çertifikatës Ndërkombëtare Cambridge English, nga A1 deri në C2. Në mars 2017, Cambridge Centre AL008 "Zoja e Këshillit të Mirë", në vijim të inspektimit surprizë të Cambridge, ka arritur vlerësimin Overall rating: Excellent. Pas një Auditi nga Inspections Coordinator në prill 2019, Qendra ka arritur përsëri vlerësimin Overall rating: Excellent.
Çertifikata Cambridge English është e njohur ndërkombëtarisht dhe nuk ka skadencë kohore. Provimet Cambridge English njihen për standartin e tyre të shkëlqyer dhe mundësinë që ofrojnë për hapjen e dyerve në fushën akademike dhe të punësimit.
Një vlerë e shtuar që Cambridge English i ofron kandidatit që mbron provimin, është mundësia për të kaluar automatikisht në një nivel më të lartë çertifikimi, nëse arrin rezultate të shkëlqyera në nivelin e testuar. (p.sh: B2 ►C1).
Qendra jonë Cambridge mundëson provimet, si në formatin paper-based, ashtu edhe në computer-based. Gjithashtu, ofrojmë pre-testing activity për çdo nivel. Datat e provimeve janë shumë të shpeshta dhe rezultatet spallen në një kohë të shkurtër. Gjithashtu, qendra ofron standardet më të larta për sigurinë e materialeve të provimeve si dhe garanton rregullsinë e proçedurave.

# PRESENTAZIONE DEL
# PRESIDE DI FARMACIA

A partire dal 1 gennaio 2019, su nomina del Magnifico Rettore Prof. Bruno Giardina, si è insediato il nuovo Preside della Facoltà di Farmacia, Prof. Roberto Perrone, professore ordinario di Chimica Farmaceutica e già Preside, dal 2008 al 2018, della Facoltà di Farmacia dell'Università di Bari. Nei primi incontri che il nuovo Preside ha voluto da subito avere con gli studenti dei cinque anni del CdS e con i docenti è stato manifestato l'impegno di fare squadra tra docenti e discenti al fine di rendere sempre più efficace la didattica erogata e sempre più efficiente il rendimento del percorso formativo, al fine di avere dei *professionisti del farmaco*, così come piace chiamarli il nuovo Preside, con una buona preparazione. Altro impegno del nuovo Preside è quello di curare molto la formazione post-laurea, mediante l'attivazione di Masters di II livello, corsi di Dottorato di Ricerca, al fine di rafforzare ulteriormente la preparazione in alcuni ambiti specifici che sono utili per differenziare la possibilità di spendibilità del titolo di studio in altri settori oltre quello della distribuzione dei farmaci nelle farmacie. Ulteriori stimoli utili per gli studenti ed il corpo docenti saranno i seminari ed eventi scientifici, organizzati su varie tematiche del settore farmaco e prodotti per la salute.



## CORSO DI LAUREA IN FARMACIA

Il Corso di laurea in Farmacia è un corso di studi inter-Ateneo Internazionale con l'Università degli Studi di Bari, UNIBA, con mobilità dei docenti da Bari a Tirana, e ha ricevuto formale accreditamento dalle Autorità Ministeriali dei due paesi, Albania-Italia, per la spendibilità del titolo accademico sia in Albania che in Italia. Al termine degli studi, a ciclo unico quinquennale, viene rilasciato il titolo congiunto di dottore in Farmacia a firma dei Rettori dei due paesi e quindi è possibile sostenere l'Esame di Stato nei due paesi per l'abilitazione all'esercizio della professione di Farmacista. Il piano di studi del corso di laurea, attivato con UNIBA a partire dall'a.a. 2014-15, è identico tra i due Atenei ed è stato rinnovato totalmente a partire dall'a.a. 2017-18 per renderlo analogo ad un modello nazionale moderno ed attuale ai tempi adottato dalla maggior parte delle sedi Universitarie italiane in conformità alle direttive della U.E. La missione del coso di laurea in Farmacia così ristrutturato è quello di offrire agli studenti un percorso formativo di alto livello, sia teorico che pratico, per "imparare a conoscere, progettare, preparare ed usare i farmaci e i prodotti per la salute. Il Preside di Farmacia è il prof. Roberto Perrone, già Preside per 10 anni della Facoltà di Farmacia di UNIBA.

# PREZANTIMI I **DEKANIT TË FARMACISË**

Duke filluar nga 1 janari 2019, me emërim të Rektorit Prof. Bruno Giardina, u zgjodh Dekani i ri i Fakultetit të Farmacisë, Prof. Roberto Perrone, profesor i Kimisë Farmaceutike dhe Dekan, nga viti 2008 deri në vitin 2018, i Fakultetit të Farmacisë në Universitetin e Barit. Në takimet e para që Dekani i ri realizoi me studentët e pesë viteve të Kursit dhe pedagogët, u shfaq angazhimi për një model skuadre, mes pedagogëve dhe studentëve, me synimin e rritjes së efikasitetit didaktik dhe performancës së kursit, në mënyrë që të ketë *profesionistë të farmaceutikës*, siç i pëlqen t'i quajë Dekani i ri, me një përgatitje të mirë. Një angazhim tjetër i Dekanit është që të kujdeset për trajnimin pas-universitar, nëpërmjet aktivizimit të masterit të nivelit II, të Doktoratës, në mënyrë që të forcohet më tej përgatitja në disa fusha specifike që janë të dobishme për të dalluar mundësinë e kualifikimit në sektorë të tjerë, përveç shpërndarjes së barnave në farmaci. Stimuj të mëtejshëm të dobishëm për studentët dhe stafin mësimdhënës do të jenë seminaret dhe takimet shkencore, me tema të ndryshme në sektorin e produkteve farmaceutike dhe produkteve të shëndetit.

## PROGRAMI I STUDIMIT NË FARMACI

Programi i studimit në Farmaci është një kurs ndër-Universitar Ndërkombëtar me Universitetin e Studimeve të Barit, UNIBA, me praninë e docentëve të Barit në Tiranë dhe ka marrë akreditim formal nga Autoritetet Ministrore të të dy vendeve, Shqipëri-Itali, për përdorimin e titullit akademik si në Shqipëri ashtu edhe në Itali. Në përfundim të studimeve, me cikël unik pesë vjeçar, lëshohet diploma e përbashkët në Farmaci, nënshkruar nga Rektorët e të dy vendeve dhe prandaj është e mundur të zhvillohet Provimi Shtetëror në të dy vendet, për kualifikimin e ushtrimit të profesionit të Farmacistit. Programi i studimit i aktivizuar me UNIBA duke filluar nga viti akademik 2014-15, është identik midis dy universiteteve dhe është rinovuar tërësisht, prej vitit akademik 2017-18, për t'a bërë të ngjashëm me një model modern dhe aktual, në përdorim nga shumica e Universiteteve italiane, në përputhje me direktivat e BE-së. Synimi i diplomës në Farmaci është t'u ofrojë studentëve një rrugëtim formativ të nivelit të lartë, teorik dhe praktik, për të "mësuar, projektuar, përgatitur dhe përdorur ilaçe dhe produkte shëndetësore". Dekani i Farmacisë është prof. Roberto Perrone, për 10 vjet ish Dekan në Fakultetin e Farmacisë të UNIBA-s.

# EUROPEAN RESPIRATORY SOCIETY

## Malvina Hoxha

Delegato Nazionale dell'Albania
Delegate për Shqipërinë

Malvina Hoxha, docente di Farmacologia, presso la Facoltà di Farmacia (Dipartimento di Valutazione-Chimica Tossicologica e Farmacologica dei Farmaci), è stata eletta a gennaio 2019 come Delegato Nazionale dell'Albania alla ERS (European Respiratory Society). La dott. ssa Hoxha è riuscita ad ottenere la maggioranza dei voti, dai membri della ERS di tutti i paesi europei. Questo incarico per dott.ssa Hoxha inizia ufficialmente a ottobre 2019, nel congresso scientifico annuale della ERS a Madrid, dove è stata programmata una cerimonia a riguardo.
ERS (European Respiratory Society) è una società dedicata alla medicina respiratoria e alla scienza, che produce anche linee guida cliniche. Essa comprende 11 assemblee scientifiche, che coprono l'intero ambito del settore, a cui aderiscono circa 10 mila membri. La società gioca un ruolo chiave, nel migliorare i criteri della medicina respiratoria in Europa e non solo. Il congresso annuale è il forum principale in Europa dove esperti mondiali svolgono le comunicazioni congressuali, e che attrae circa 20 mila delegati.

Malvina Hoxha, docente e Farmakologjisë, në Fakultetin e Farmacisë (Departamenti për Vlerësimin Kimik - Toksikologjik dhe Farmakologjik të Barnave), u zgjodh në Janar 2019, Delegate Kombëtare për Shqipërinë në ERS (European Respiratory Society). Dr. Hoxha arriti të marrë shumicën e votave nga anëtarët e ERS-së, profesionistë dhe akademikë të vendeve europiane. Këtë mandat, Dr. Hoxha do t'a marrë zyrtarisht në tetor 2019, në kongresin vjetor shkencor të ERS në Madrid, ku do të zhvillohet edhe një ceremoni e posaçme.
ERS është një shoqatë që i kushtohet sëmundjeve respiratore dhe shkencës, gjithashtu nxjerr udhëzime për trajtimin klinik të sëmundjeve respiratore. Ajo përfshin 11 asamble shkencore që mbulojnë të gjitha fushat e sektorit dhe ka rreth 10 mijë anëtarë. ERS luan një rol kyç në përmirësimin e kritereve të mjekësisë respiratore në Europë dhe më gjerë. Kongresi vjetor është forumi kryesor në Europë për fushën respiratore, ku marrin pjese 20 mijë delegatë si dhe ekspertët më të njohur të fushës, të cilët prezantojnë punimet e tyre shkencore.

## Sorgerà presso l'Università Cattolica NSBC
## il nuovo Laboratorio di Biologia molecolare finanziato dalla NATO

L'Università Cattolica "Nostra Signora Buon Consiglio" sarà partner ufficiale del progetto "Early detection and diagnosis of emerging biological threats" (2019 – 2021), coordinato dall'Università Statale di Milano ed in collaborazione con l'Università Nazarbayev, Astana in Kazakhstan.
Il progetto, si colloca all'interno del Programma NATO, Scienza per la Pace e la Sicurezza, (Science for Peace and Security SPS programme, NATO) ed ha lo scopo di sviluppare e validare un nuovo dispositivo biosensore elettro-ottico basato, su fibre di silice, per il rilevamento precoce di virus potenzialmente letali, rilasciati accidentalmente o a scopo bioterroristico.
Nell'ambito del progetto sarà realizzato un laboratorio di Biologia e Virologia molecolare, unico in Albania per il tipo di ricerca, localizzato presso l'Università Cattolica NSBC e di cui è responsabile il Prof. Carlo De Giuli Morghen. La fiducia nella qualità della ricerca e gli eccellenti risultati scientifici ottenuti dalla UCNSBC hanno portato questo importantissimo progetto in Albania.
Il programma Scienza per la Pace e la Sicurezza (SPS), ha lo scopo di promuovere il dialogo e la cooperazione pratica tra gli Stati membri della NATO e le nazioni partner, sulla base della ricerca scientifica, dell'innovazione tecnologica e dello scambio di conoscenze.

## Ngritja në Universitetin Katolik ZKM
## e Laboratorit të i ri të Biologjisë Molekulare i financuar nga NATO

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" do të jetë partner zyrtar i projektit "Early detection and diagnosis of emerging biological threats" (2019 – 2021), koordinuar nga Universiteti Shtetëror i Milanos dhe në bashkëpunim me Universitetin Nazarbayev, Astana në Kazakistan.
Projekti është pjesë e Programit të NATO-s, Shkenca për Paqen dhe Sigurinë (Science for Peace and Security (SPS) programme, NATO), dhe synon të zhvillojë dhe të testojë një pajisje të re, biosensor elektro-optik me fibra silici, për zbulimin e hershëm të viruseve potencialisht vdekjeprurës, të lëshuar aksidentalisht ose për qëllime bioterrorizmi.
Pjesë e projektit është ndërtimi i një laboratori Biologjie dhe Virologjie molekulare, i vetmi i këtij lloji në Shqipëri për llojin e kërkimit, i lokalizuar brenda Universitetit Katolik ZKM, dhe për të cilin është përgjegjës Prof. Carlo De Giuli Morghen. Besimi në cilësinë e kërkimit dhe rezultatet e shkëlqyera shkencore të arritura nga UKZKM, e kanë sjellë këtë projekt shumë të rëndësishëm në Shqipëri.
Programi i Shkencës për Paqen dhe Sigurinë (SPS), synon të promovojë dialogun dhe bashkëpunimin praktik, midis shteteve anëtare të NATO-s dhe vendeve partnere, bazuar në kërkimin shkencor, inovacionin teknologjik dhe shkëmbimin e njohurive.

NATO OTAN
This publication is supported by: The NATO Science for Peace and Security Programme




**Conferenza**
I Difetti alla Nascita, Una Sola Voce

**Konferenca**
Defektet në Lindje, Një Zë i Vetëm



Il 3 Marzo scorso si è celebrata la quinta Giornata Mondiale sui Difetti Congeniti e, su iniziativa del Dipartimento per la Valutazione Chimico-Tossicologica e Farmacologica dei Farmaci, la nostra Università é stata accettata come partner ufficiale per l 'Albania.

Nel 2015, 12 organizzazioni internazionali che si occupano di difetti congeniti, lanciarono l'idea della giornata mondiale dei difetti congeniti. Lo scopo era fondamentalmente quello di far crescere la consapevolezza di quanto grave sia, a livello mondiale, questo problema; fornire a tutte le organizzazioni coinvolte un punto di vista comune (one global voice) ed una piattaforma in grado di migliorare la sorveglianza, la prevenzione, l'assistenza e la ricerca sui difetti congeniti; accrescere la consapevolezza di quanto pesantemente incidano, a livello mondiale, la mortalità e la disabilità conseguenti ai difetti congeniti e accrescere la consapevolezza della necessità di un'assistenza precoce e che duri tutta la vita del paziente con difetti congeniti, con l'obiettivo di migliorarne la qualità della vita e la sua partecipazione alla vita sociale.

Nel prossimo quinquennio 2019-2023, ci si augura la mobilitazione di risorse ed impegno economici, politici ed individuali per migliorare la sorveglianza, la ricerca, la prevenzione e l'assistenza dei pazienti affetti da difetti congeniti.

Nell'ambito della ricorrenza di questa giornata sono stati organizzati degli eventi scientifici e divulgativi nei mesi di Marzo e Aprile, come la Conferenza Internazionale "Prevenzione dei difetti congeniti in Albania: Stato dell'arte e prospettive future" in collaborazione con il Ministero della Salute Italiano e il Ministero della Salute e della Previdenza Sociale Albanese", il seminario "Difetti congeniti: promozione della salute riproduttiva della donna" e nella sede di Elbasan dell' Università il seminario "Pensiamoci prima: Malattie genetiche". Inoltre, è organizzata una manifestazione sportiva "Running for healthy babies".



# **World Birth** Defects Day

Në 3 mars u përkujtua Dita Botërore e Defekteve në Lindje, dhe me iniciativën e Departamenti për Vlerësimin Kimik –Toksikologjik dhe Farmakologjik të Barnave, Universiteti ynë u pranua si partner zyrtar për Shqipërinë. Në vitin 2015, 12 organizata ndërkombëtare që merren me defektet në lindje nisën idenë e ditës botërore të defekteve në lindje. Qëllimi ishte rritja e ndërgjegjësimit për serioziozitetin e sëmundjeve, në mbarë botën; duke i siguruar të gjitha organizatave të përfshira mbi pikëpamje të përbashkëta (një zë global) dhe një platformë për mbikëqyrjen, parandalimin, asistencën dhe kërkimin mbi defektet e lindura; rritje e ndërgjegjësimit mbi peshën që kanë, në nivel botëror, vdekshmëria dhe aftësitë e kufizuara të lidhura me këto defekte dhe rritjen e ndërgjegjësimit për nevojën e kujdesit të hershëm dhe gjithë jetës së pacientit me defekte të lindjes, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës dhe pjesëmarrjen në jetën shoqërore. Në periudhën e ardhshme pesë vjeçare 2019-2023, shpresohet në mobilizimin e burimeve ekonomike, politike dhe individuale për të përmirësuar mbikëqyrjen, kërkimin, parandalimin dhe asistencën e pacientëve që vuajnë nga defektet e lindura.

Në kuadër të kësaj dite, u organizuan evente shkencore dhe informuese gjatë muajve Mars dhe Prill, siç është Konferenca Ndërkombëtare "Parandalimi i defekteve të lindjes në Shqipëri: Gjendja dhe perspektivat e ardhshme", në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë italiane dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtes Sociale shqiptare, seminarin" Dëmet kongjenitale: promovimi i shëndetit riprodhues të grave" dhe në selinë e Elbasanit seminari "T'a mendojmë më parë: Sëmundjet gjenetike". Gjithashtu, u zhvillua një aktivitet sportiv, "Vrapo për foshnjat e shëndetshme".

PRESENTAZIONE DEL
# PRESIDE DI ARCHITETTURA

Fabio Capanni è Professore Ordinario in Composizione Architettonica e Urbana presso il DIDA, Dipartimento di Architettura dell'Università di Firenze, dove ha conseguito il Dottorato di ricerca nel 2000.
Ha collaborato con la rivista Materia ed è stato redattore della rivista Area; è membro del Comitato Scientifico di Firenze Architettura. E' autore di: Architettura moderna a Fiesole; Di alcune figure e caratteri dell'edilizia residenziale in Toscana nell'orizzonte della sostenibilità; Spazio, Luce, Architettura; La Forma della Luce; Architettura e Luce, e di numerosi articoli e saggi.

E' Direttore della collana Lumina per Lettera Ventidue, che si occupa rapporto tra luce naturale e architettura ed è responsabile scientifico di ReThink Daylight, un progetto internazionale promosso da Velux.
Alcune sue opere sono state premiate e pubblicate sulle maggiori riviste nazionali ed internazionali, tra le quali: Palestra "La Fonte" a Sesto Fiorentino; Sezione archeologica del Museo di S. Agostino a Montalcino; Ampliamento delle scuole Stefanacci e Tagliaferro a San Piero a Sieve.

Dal 1° Gennaio 2019 è Preside della Facoltà di Scienze Applicate alla UCNSBC e insegna nel Corso di Laurea in Architettura che, in virtù della convenzione per il Doppio Titolo con Il Dipartimento di Architettura DIDA dell'Università di Firenze, rappresenta una vera e propria porta per entrare in Europa. Caratterizzato da un livello di eccellenza grazie alla presenza dei migliori docenti del DIDA, il Corso di Laurea in Architettura si distingue per la sua dimensione internazionale ed è stato concepito per formare una figura di architetto colta e tecnica allo stesso tempo, capace di governare le complesse trasformazioni dello spazio e dell'ambiente contemporanei per mezzo del progetto di architettura alle sue diverse scale: da quella architettonica a quella urbanistica, da quella tecnologica a quella del design e del restauro, coordinando le molteplici competenze che concorrono al progetto: da quelle strutturali a quelle impiantistiche, da quelle normative a quelle economiche.



# PREZANTIMI I **DEKANIT TË ARKITEKTURËS**

Fabio Capanni është Profesor i lëndës Projektim Arkitektonik dhe Urban në DIDA, Departamenti i Arkitekturës i Universitetit të Firences, ku ka përfunduar edhe doktoratën në vitin 2000.

Ai ka bashkëpunuar me revistën Materia dhe ka qënë redaktor i revistës Area; është anëtar i Komitetit Shkencor të Arkitekturës së Firences. Autor i: Arkitektura Moderne në Fiesole; Mbi disa figura dhe karaktere të ndërtesave rezidenciale në Toskana në horizontin e qëndrueshmërisë; Hapësira, Drita, Arkitektura; Forma e Dritës; Arkitektura dhe Drita, dhe autor i shumë artikujve dhe eseve.

Ai është drejtor i serisë Lumina për Lettera Ventidue, e cila merret me marrëdhënien midis dritës natyrore dhe arkitekturës, dhe është përgjegjës shkencor i ReThink Daylight, një projekt ndërkombëtar i promovuar nga Velux. Disa nga veprat e tij kanë marrë çmime dhe janë botuar në revista të mëdha kombëtare dhe ndërkombëtare, mes tyre: Palestra "La Fonte" në Sesto Fiorentino; Seksioni arkeologjik i Muzeut të S. Agostinos në Montalcino; Zgjerimi i shkollave Stefanacci dhe Tagliaferro në San Piero a Sieve.

Prej 1 janarit 2019, ai është Dekan i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara, UKZKM dhe jep mësim në Degën e Arkitekturës e cila, në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për Diplomën e Dyfishtë me Departamentin e Arkitekturës DIDA të Universitetit të Firences, vlen si një derë për të hyrë në Europë. I karakterizuar nga një nivel i shkëlqyer falë pranisë së pedagogëve më të mirë të DIDA, Programi i Studimit në Arkitekturë dallon për dimensionin e tij ndërkombëtar dhe është konceptuar për të formuar një figurë arkitekti, erudite dhe teknike në të njëjtën kohë. Kjo figurë është e aftë të menaxhojë kompleksitetin e transformimit të hapësirës dhe ambjenteve bashkëkohore, nëpërmjet shkallëve të ndryshme të projekteve arkitekturore: nga ajo arkitektonike tek planifikimi urban, nga teknologjia tek dizajni dhe restaurimi, duke koordinuar kompetencat e shumta të një projekti: nga ato strukturore tek impiantet, nga rregullatoret tek aspektet ekonomike.

# PROGETTI
## DEL PROGRAMA DI ARCHITETTURA

Si dice che gli architetti imparano praticando..., quindi la pratica durante gli anni universitari è fonadamentale per la loro formazione.

All'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio", gli studenti sono parte attiva dei vari progetti. In collaborazione col partner accademico, l'Università degli Studi di Firenze è stato finalizzato un Workshop condotto a Argirocastro, dove sono state effettuate e documentate le misurazioni di alcune delle case caratteristiche. Le misurazioni tramite tecnologia avanzata, nonché lo studio urbano e morfologico della città saranno messe al servizio ed in funzione dello sviluppo del distretto di Argirocastro.

Studenti e docenti del Programma di Studio in Architettura della UCNSBC e UNIFI, assieme al personale dell'Istituto dei Monumenti di Cultura hanno effettuato una spedizione di due giorni, a Rehova, in Kolonjë.

È stata realizzata la rilevazione, la documentazione grafica e descrittiva, evidenziando le problematiche e gli interventi per le «76 Porte di Rehova", che serviranno da modello base per la realizzazione del progetto di restauro.

Questo progetto, dove partecipano i studenti di architettura della UCNSBC, mira a valutare ed evidenziare, attraverso la creazione di un percorso architettonico - turistico - culturale delle Porte di Rehova.

L'iniziativa è stata sostenuta dal Ministero della Cultura, a seguito delle continue collaborazioni, come nel caso del programma del governo albanese "Accademia 100 Villaggi", nel quale gli studenti di architettura della UCNSBC hanno progettato il modello di sviluppo del Lotto 8, in base del potenziale turistico.

# PROJEKTET
## NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË ARKITEKTURËS

Thuhet se Arkitektët mësojnë duke u praktikuar..., ndaj edhe praktika përgjatë studimeve universitare është faktor kyç për formimin e tyre.

Në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", studentët janë pjesë aktive e projekteve të ndryshme. Në bashkëpunim me partnerin akademik, Universitetin e Studimeve të Firences u finalizua një Workshop-i i realizuar në Gjirokastër, ku u kryen dhe dokumentuan matjet (rilevimet) e disa prej shtëpive karakteristike gjirokastrite. Matjet me teknologji të avancuar, si dhe studimi urbanistik dhe morfologjik i qytetit do të vihen në shërbim dhe funksion të zhvillimit të Qarkut të Gjirokastrës.

Studentë dhe pedagogë të Programit të Studimit të Arkitekturës në UKZKM dhe UNIFI, bashkë me stafin e Institutit të Monumenteve të Kulturës kryen një ekspeditë dy ditore, në Rehovë të Kolonjës.

U realizua rilevimi, dokumentimi grafik dhe përshkrimor, evidentimi i problematikave dhe ndërhyrjet, për "76 Portat e Rehovës", dokumente të cilat do të shërbejnë si model bazë për realizimin e projektit të restaurimit.

Ky projekt, ku marrin pjesë studentët e Arkitekturës të UKZKM ka për qëllim vlerësimin dhe evidentimin, nëpërmjet krijimit të një itinerari arkitektonik - turistik - kulturor, të Portave të Rehovës.

Iniciativa u mbështet nga Ministria e Kulturës, në vijim të bashkëpunimeve të suksesshme, si në rastin e Programit të qeverisë shqiptare "Akademia 100 Fshatrat", ku studentët e Arkitekturës UKZKM, hartuan modelin e zhvillimit të Lotit 8, bazuar në potencialin turistik.











# PONTE DI ESPERIENZE
## TIRANA - FIRENZE

Gli studenti del IV anno, del Programma di Studi in Architettura hanno partecipato ad un programma didattico di un mese, presso l'Università degli Studi di Firenze, nostro partner accademico.
L'esperienza didattica presso il Dipartimento di Architettura di Firenze (DIDA), serve ai giovani, per l'inquadramento e la futura formazione come architetti.
I nostri studenti, oltre alla pratica sul campo, hanno l'opportunità di frequentare una serie di seminari interattivi e interessanti, come nel caso del seminario "Ecomuseo dell'Arno", svoltosi a maggio 2019, a Firenze.
Il Programma di Studi in Architettura prevede il completamento dei crediti, basati sul perseguimento di corsi a Firenze, durante il IV e V anno di studi.
Gli studenti ricevono un doppio titolo, al termine degli studi in Architettura, grazie alla collaborazione dell'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" con l'Università degli Studi di Firenze.



# URA EKSPERIENCE
## TIRANË - FIRENCE

Studentët e vitit të IV-t të Programit të Studimit në Arkitekturë, ndoqën përreth një muaj, programin mësimor pranë Universitetit të Studimeve të Firences, partneri ynë akademik.

Eksperienca didaktike pranë Departamentit të Arkitekturës në Firence (DIDA), u shërben të rinjve për kompletimin dhe formimin e tyre të ardhshëm profesional si arkitektë. Studentët tanë, përveç praktikës në terren kanë mundësinë të ndjekin një cikël seminaresh interaktivë dhe interesantë, si në rastin e "Ekomuzeu i Arnos", seminar i zhvilluar në muajin Maj 2019, në Firence.

Programi i Studimeve në Arkitekturë parashikon plotësimin e krediteve, bazuar në ndjekjen e lëndëve në Firence, gjatë vitit të IV-t dhe të V-të të studimeve.

Studentëve u lëshohet diplomë e dyfishtë në përfundim të studimeve në Arkitekturë, falë bashkëpunimit të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", me Universitetin e Studimeve të Firences.



Alessandro Merlo, Dottore di Ricerca e Professore Associato nel Settore Scientifico Disciplinare Icar/17, è titolare dei corsi di "Rilievo dell'Architettura", "Disegno dell'Architettura" e "Rappresentazione della città, del territorio e del paesaggio", presso la Scuola di Architettura di Firenze e del "Laboratorio di Rilievo per il Restauro", presso l'Università "Nostra Signora del Buon Consiglio" a Tirana. È direttore del Master di II livello "Documentazione e Gestione dei Beni Culturali", dell'Unità di Ricerca DM_SHS (Documentation and Management of Small Historical Settlements) e del CHMLab (Cultural Heritage Management Lab). È membro del collegio del dottorato della Scuola di Architettura di Firenze; è socio dell'UID e dell'ISUF International ed è nel comitato scientifico delle riviste "U+D" e "Restauro Archeologico", ed in quello di redazione della collana "Studi e Documenti di Architettura" e "Firenze Architettura" (fino al 2013). La sua attività di ricerca, che egli conduce a livello internazionale, è rivolta in particolare ai:

- Sistemi integrati di rilevamento per l'analisi dei processi di formazione e trasformazione degli edifici, della città e del territorio,
- Procedimenti di reverse modeling per l'architettura e la città,
- Sistemi informativi 3D per la fruizione dei dati digitali derivanti da campagne di rilevamento integrato,
- Rilevamento digitale e modellazione 3D in ambito archeologico,
- Documentazione, tutela, valorizzazione e gestione dei beni culturali.

All'interno dei Laboratori di "Rilievo dell'Architettura" e di "Rilievo per il Restauro" dell'Università NSBC, Merlo ha condotto in Tirana il rilievo analogico della chiesa cattolica Zemra e Krishtit (Sacro Cuore) dei padri Gesuiti in Rruga e Kavajës (2016) e di quella ortodossa Ungjillëzimi (2017) nella stessa strada. Nel 2018 ha diretto, sotto forma di workshop interdisciplinare (con la collaborazione dei proff.ri Francesco Tioli, Letizia Dipasquale, Stefano Galassi, Massimo Carta e degli architetti Leonardo Germani, Stefania Franceschi, Giulia Lazzari e Francesco Frullini), la campagna di documentazione di parte del tessuto edilizio di Argirocastro e, in particolare, di tre abitazioni vernacolari denominate Zekate House, Fico House e Dalipi House, delle quali sono stati rilevati digitalmente i dati morfometrici e cromatici, analizzate le tecniche costruttive e le componenti strutturali e, infine, desunto il quadro generale dello stato di conservazione.

# CONOSCETE IL / NJIHUNI ME PROF. **ALESSANDRO MERLO**

Alessandro Merlo, Profesor i Asocuar në Sektorin Disiplinor Shkencor Icar/17, titullar i kurseve të "Studimit Arkitekturor", "Dizajn Arkitekturor" dhe "Përfaqësimi i qytetit, territorit dhe peisazhit", në Shkollën e Arkitekturës së Firences dhe i "Laboratorit të Restaurimeve", në Universitetin "Zoja e Këshillit të Mirë", në Tiranë. Ai është drejtor i Masterit të Nivelit të II në "Dokumentim dhe Menaxhim i Trashëgimisë Kulturore", i Njësisë Kërkimore DM_SHS (Documentation and Management of Small Historical Settlements) dhe i CHMLab (Cultural Heritage Management Lab). Ai është anëtar i shkollës doktorale të Shkollës së Arkitekturës në Firence; anëtar i UID dhe ISUF International dhe është pjesë e komitetit shkencor të revistave "U + D" dhe "Restaurimi Arkeologjik", dhe komitetin e redaktorëve të serisë "Studime dhe Dokumente Arkitekturore" dhe "Arkitektura Firence" (deri në 2013 ). Veprimtaria e tij kërkimore, të cilën ai e zhvillon në nivel ndërkombëtar, synon në veçanti:

- Sisteme të integruara të hartëzimit për analizën e proçeseve të formimit dhe transformimit të ndërtesave, qytetit dhe territorit,
- Proçedura Reverse modeling për arkitekturën dhe qytetin,
- Sisteme informacioni 3D për përdorimin e të dhënave digjitale, që rrjedhin nga fushatat e studimit të integruar,
- Digjitalizimi dhe modelimi 3D në fushën arkeologjike,
- Dokumentimi, mbrojtja, vlerësimi dhe menaxhimi i pasurive kulturore.

Në Laboratorët e "Rilevimi Arkitekturës" dhe "Rilevimi për Restaurim", të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Merlo udhëhoqi në Tiranë studimin analogjik të kishës katolike Zemra e Krishtit të etërve Jezuitë në Rrugën dhe Kavajës (2016) dhe asaj orthodhokse të Ungjillëzimit (2017), në të njëjtën rrugë. Në vitin 2018 drejtoi, në formën e një seminari ndërdisiplinor (në bashkëpunim me profesorët Francesco Tioli, Letizia Dipasquale, Stefano Galassi, Massimo Carta dhe arkitektët Leonardo Germani, Stefania Franceschi, Giulia Lazzari dhe Francesco Frullini), pjesë të strukturave të ndërtesave në Gjirokastër, dhe në veçanti të tri banesave popullore të quajtura Shtëpia Zekate, Shtëpia Fico dhe Shtëpia Dalipi, nga të cilat u analizuan të dhënat morfometrike dhe kromatike, teknikat e ndërtimit dhe komponentët strukturorë dhe, së fundi, nxorri në pah kuadrin e përgjithshëm të gjendjes së ruajtjes.




Per conto del Ministero di Cultura sono stati inoltre rilevati con tecniche e strumenti digitali, il teatro dell'Accademia di Belle Arti aTirana, la chiesa della Natività di Santa Maria a Labovë e Kryqit, i portali di accesso alle corti private dell'insediamento rurale di Rehovë e quattro edifici ed un portale di rilevanza storico-architettonica, del villaggio di Dhoksat (all'interno del programma "100 villaggi")..

---

Me kërkesë të Ministrisë së Kulturës, u hartua me teknika dhe instrumente digjitale, teatri i Akademisë së Arteve të Bukura në Tiranë, Kishës e Lindjes së Shën Mërisë në Labovë të Kryqit, portat hyrëse në Rehovë dhe katër ndërtesa e një portë me rëndësi historike dhe arkitektonike në fshatin Dhoksat, si pjesë e programit "100 fshatrat".

# GIORNATA APERTA
## TEMPO DI SCELTE

L'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio" ha aperto le porte ai maturandi durante la Giornata Aperta, il 13 aprile 2019.

Gli studenti delle scuole secondarie superiori da tutto il paese hanno avuto l'opportunità di visitare il campus, i laboratori, le cliniche, la biblioteca e le altre strutture di interesse dell'Università.

Si sono informati dettagliatamente sui singoli corsi di laurea, la durata, i criteri d'ammissione ai corsi in Architettura, Medicina, Odontoiatria e Protesi Dentaria, Farmacia, Fisioterapia, Infermieristica ed Economia.
Tale iniziativa ha l'obiettivo di offrire un ulteriore aiuto alle future matricole per scegliere con consapevolezza il proprio percorso di studi entrando nel merito di quelli che sono gli obiettivi formativi, le opportunità professionali e i punti di forza di ciascun corso.

# DITA E HAPUR
## KOHA PËR TË ZGJEDHUR

Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" mirëpriti maturantë nga e gjithë Shqipëria në Ditën e Hapur, organizuar më 13 prill 2019.

Nxënësit e shkollave të mesme vizituan kampusin universitar, laboratorët, klinikat, bibliotekën dhe ambientet e tjera të Universitetit.
Ata morën informacion të detajuar mbi programet e studimit, kohëzgjatjen e tyre, kriteret e pranimit në degët: Arkitekturë, Mjekësi, Odontoiatri dhe Protezë Dentare, Farmaci, Fizioterapi, Infermieri dhe Ekonomi.

Qëllimi i këtyre inciativave është që të ndihmojë matrikullat e ardhshme, të zgjedhin me vetëdije rrugëtimin universitar, duke nxjerrë në pah objektivat akademike, mundësitë profesionale dhe elementët karakterizues të çdo programi studimi.










INFERMIERI

FARMACI





OPEN


DAY

# CONSIGLIO STUDENTI // KËSHILLI I STUDENTËVE

Il giorno 28 Marzo 2019, si è riunita la Commissione di Elezioni Consiglio Studenti dell'Università Cattolica "Nostra Signora del Buon Consiglio". Il Consiglio Studenti dell'Università composto da 37 membri, ha scelto:

**Francesco Gareri**
Responsabile del Consiglio Studenti dell'Università
**Dario Bello**
Rappresentante al Senato Accademico
**Joni Mersini**
Rappresentante nel Nucleo di Valutazione della Qualità
**Klajdi Xhepa**
Rappresentante nel Consiglio Nazionale degli Studenti

La validità delle cariche elettive è di 2 anni.

Më 28 mars 2019, u mblodh Komisioni i Zgjedhjeve të Studentëve të Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë". Këshilli i Studentëve të Universitetit që përbëhet nga 37 anëtarë, zgjodhi:

**Francesco Gareri**
Kryetar i Këshillit të Studentëve të Universitetit
**Dario Bello**
Përfaqësues i Senatit Akademik
**Joni Mersini**
Përfaqësues në Njësinë e Vlerësimit të Cilësisë
**Klajdi Xhepa**
Përfaqësues në Këshillin Kombëtar të Studentëve

Vlefshmëria e mandatit është 2 vjet.






Carissimi,

Saluti di pace dalla Pastorale universitaria. Prima di tutto vi ringrazio per l'attiva partecipazione del nostro incontro di 21 marzo sul tema: **IL RUOLO DEI GIOVANI NELLO SVILUPPO DI UNA SANA SOCIETÀ**". Ringrazio tutti quelli che hanno collaborato per questo evento. Siamo all'inizio di un'altra Stagione Santa della Quaresima in cui contempliamo i misteri pasquali di Cristo: la sua passione, morte e risurrezione, con la quale ha stabilito la redenzione oggettiva dell'intera creazione. L'osservanza ravvicinata di questo fatto e la contemplazione di quei misteri dovrebbero portarci a pensare di più alla nostra redenzione soggettiva, così che il nostro focus sarà esclusivamente su questioni spirituali che ci aiutano a santificare il nostro intero essere. L'invito della Santa Chiesa cattolica a dedicare più tempo alla preghiera, alla penitenza, all'accoglienza dei sacramenti, al digiuno e all'astinenza è rivolto a questo aspetto della santificazione personale e quindi alla nostra redenzione soggettiva. Il dolore fisico e mentale e i sacrifici che subiamo e intraprendiamo dovrebbero condurci alla purificazione del nostro corpo, mente e anima, incluse ogni facoltà, e infondere speranza dentro di noi, portandoci alle altezze spirituali o ai momenti di grazia straordinari. Papa Francesco si concentra su tre punti importanti nel suo messaggio di quaresima 2019: 1. la redenzione della creazione, 2. il potere distruttivo del peccato e 3. il potere di guarigione del pentimento e del perdono. La celebrazione dei misteri pasquali ci chiama ad intraprendere un cammino di preparazione, nella consapevolezza che il nostro essere conformi a Cristo è un dono inestimabile della misericordia di Dio. È davvero un compito impegnativo rimanere in quello stato di essere tutt'uno con Cristo, poiché la nostra debole e fragile natura umana spesso ci tira indietro per godere dei piaceri momentanei di questo mondo e per commettere peccato. Le osservanze quaresimali, in particolare il digiuno e la preghiera, sono veri mezzi per superare quelle tendenze della carne. Tutti questi mezzi sono e dovrebbero rimanere come mezzi per godere dei frutti della risurrezione. Che questa stagione della Quaresima sia un viaggio per trovare il vero tesoro, un viaggio verso la conversione personale, un viaggio insieme al nostro Maestro al Calvario e anche oltre.

Fraternamente
*P. Michael Sebastian*

Të dashur,

Përshëndetje dhe paqe nga Baritorja universitare. Së pari, ju falenderoj për pjesëmarrjen aktive në takimin e datës 21 mars me temën: "**ROLI I TË RINJVE NË ZHVILLIMIN E NJË SHOQËRIE TË SHËNDETSHME**". Falenderoj të gjithë bashkëpunëtorët në këtë event. Jemi në fillimim e një tjetër Kohe të Shenjtë të Kreshmës, kohë në të cilën kremtojmë misteret e pashkës së Krishtit: pasionin e tij, vdekjen dhe ringjalljen, nëpërmjet të cilës ka vendosur faljen objektive të të gjithë krijimit. Shqyrtimi i këtij fakti dhe kremtimi i mistereve duhet të na bëjnë të mendojmë më tepër për faljen tonë subjektive, me qëllim që objektivi ynë të priret drejt çështjeve shpirtërore, si ndihmë në shenjtërimin e gjithë qenies tonë.Ftesa e Kishës së Shenjtë Katolike për t'i kushtuar më shumë kohë lutjes, pendesës, pranimit të sakramenteve, agjërimit dhe privimit, i drejtohet këtij aspekti të shenjtërimit personal dhe, për rrjedhojë, faljes tonë subjektive. Dhimbja fizike, ajo mendore dhe sakrificat që përjetojmë duhet të na udhëheqin drejt pastrimit të trupit, mendjes dhe shpirtit tonë, përfshirë aftësitë tona, duke sjellë shpresë brenda nesh, duke na sjellë rritje shpirtërore ose momente të jashtëzakonshme dlirësie. Papa Françesku përforcon tre pika të rëndësishme në mesazhin e tij të pashkës 2019: 1. shpërblimi i krijimit 2. forca shkatërruese e mëkatit dhe 3. forca shëruese e pendesës dhe e faljes. Kremtimi i mistereve të pashkës na fton të ndërmarrim një rrugëtim përgatitjeje, duke qenë të vetëdijshëm se qënia jonë e ngjashme me Krishtin është një dhuratë e paçmueshme e mëshirës së Hyjit. Është vërtet e vështirë të mbetemi në stadin e unifikimit me Krishtin, pasi natyra jonë njerëzore e dobët dhe e brishtë, na tërheq pas për të shijuar kënaqësitë e çastit të kësaj bote dhe për të mëkatuar. Kremtimet e Pashkës, në mënyrë të veçantë agjërimi dhe lutja, janë mjetet për të kapërcyer prirjet e mishit. Të gjitha këto mjete janë dhe duhet të qëndrojnë si mjete, për të shijuar frytet e ringjalljes. Qoftë kjo kohë pashke një udhëtim, për të gjetur thesarin e vërtetë, një udhëtim drejt rikthimit personal, një udhëtim së bashku me Mësuesin tonë në Kalvar dhe përtej.

Përzemërsisht
*Atë Michael Sebastian*

# LA LUNGA E FATICOSA VIA DEL DESIDERIO

## QUALE RISPOSTA POSSIBILE PER GLI INCIAMPI, I FALLIMENTI, NELLO STUDIO, NEI LEGAMI, NELLA VITA?

*Piano ~~A~~*
*Piano B*

Sempre più spesso e da più parti, il soggetto contemporaneo sente la pressione della prestazione. Il messaggio che viene dall'Altro Sociale, compreso l'ambiente familiare, è sempre una domanda continua, pressante, mai soddisfatta, di dare di più. I motti illusori "Tu puoi tutto; Il mondo gira intorno a te; volere è potere; il mondo nelle tue mani, etc", non fanno che gettare nello sconforto chi ha il passo più corto, chi ha meno fiato, chi ha meno strumenti, per stare al passo dei più bravi. Soggetti che non ce la fanno, si fermano, cadono, inciampano, perché non si sentono all'altezza delle eccellenze. In fondo, è impossibile. Siamo diversi. Nessuno assomiglia ad un altro. Ognuno ha il proprio tempo, i propri modi di fare, ma soprattutto ha il proprio particolare desiderio di come occupare questo mondo. Ecco, dietro l'angolo appare l'ombra del fallimento, bocciatura all'esame, perdita degli amori, degli amici. Si profila lentamente una chiusura con gli altri e con il mondo. Non a caso, i disagi più diffusi oggi sono: gli attacchi di panico, varie dipendenze patologiche, depressioni, anoressia e bulimia, disturbi d'ansia. Questi disagi esprimono una sconnessione del soggetto dall'Altro, ed un'urgenza di risposta. Il soggetto stesso non si concede più il tempo di interrogarsi, di elaborare le proprie scelte, secondo la propria struttura, ma si rifugge ad una risposta immediata e rassicurante, sempre più spesso il farmaco, che deve tappare o far tacere la voce stessa del soggetto. La difficoltà di affrontare l'irruenza del proprio desiderio è un altro elemento che porta ad un altro "terremoto" che fa rifiorire l'ombra del fallimento ed un congelamento delle attività (esami, relazioni, salute). Ma il fallimento è dell'Io immaginario. Attraverso il fallimento l'inconscio si rende "visibile", avvisa che c'è qualcosa che non sta andando per il verso giusto. C'è qualcosa che sta sanguinando e fa soffrire. Ascoltare questa sofferenza è necessario ed indispensabile per aprire la via di un nuovo campo di sapere. L'esperienza psicoanalitica mi ha portato ad aver a che fare sempre con esistenze ai bordi, percorsi impaludati, vite bloccate. Accolgo ogni volta con stupore il coraggio e la dignità che queste persone mettono in campo, per poter superare i momenti bui, ma soprattutto i propri limiti. Perché di coraggio si tratta. Alzarsi in piedi per andare a bussare alla porta di uno psicologo, non è da tutti. Voler vedere le proprie questioni, aiutato da un professionista, e pronunciare le parole "Non ci riesco", non fa per chiunque. Allungare la mano verso l'Altro senza aspettare che sia l'Altro a richiamare te, è dignitoso, è umiltà, è coraggio. Fermarsi per riprendere fiato, in questo tempo che macina esistenze, è veramente rivoluzionario. Il soggetto pretende il suo posto, non si fa trascinare via come le cose che lo circondano. Sento all'inizio i loro lamenti, la colpa data sempre all'Altro, "l'anima bella" di Hegel che fa fatica a mollare la presa. Poi, la virata. "Ma sono io!". Lo sguardo si schiarisce. La voce cambia tonalità. Ed il mondo cambia la sua prospettiva ed i suoi colori.

**Dott.ssa Alketa Çoku**
Psicoterapeuta

# RRUGA E GJATË DHE E VËSHTIRË DREJT DËSHIRËS

## A KA PËRGJIGJE TË MUNDSHME PËR PENGESAT, DËSHTIMET, NË STUDIME, NË LIDHJE, NË JETË?

Gjithmonë e më shpesh dhe nga burime të ndryshme, subjekti bashkëkohor ndjen presionin e performancës. Sinjali që vjen nga Tjetri në shoqëri, përfshirë edhe ambientin familjar, është një pyetje e vazhdueshme, këmbëngulëse, e paplotësuar, për të dhënë më shumë. Sloganët iluzorë "Ti mundesh gjithçka; bota rrotullohet rreth teje; kush do, bën; ke botën në dorë; etj", s'bëjnë gjë tjetër veçse shtyjnë në dëshpërim atë që ka hapin më të shkurtër, që ka më pak mjete, për të ecur me hapin dhe në lartësinë e më të mirëve.
Subjektet që nuk arrijnë dot, ndalojnë, pengohen, sepse nuk ndihen në lartësinë e të shkëlqyerve. Në fund të fundit, është e pamundur. Jemi të ndryshëm. Asnjëri nuk i ngjan tjetrit. Secili ka kohën e vet, menyrat e veta, por mbi te gjitha ka deshira vetjake, për vendin që do të zërë në botë. Ja, pas cepit shfaqet hija e falimentimit, mos kalimi në provime, humbja e dashurive, humbja e miqve. Formëzohet ngadalë mbyllja ndaj të tjerëve dhe botës. Jo rastësisht, çregullimet më të perhapura sot janë: paniku, varësitë patologjike, depresioni, anoreksia dhe bulimia, çregullimet e ankthit. Këto çrregullime lidhen me ndarje e subjektit nga Tjetri, dhe një urgjencë në pergjigje. Subjekti nuk i jep kohë vetes për të reflektuar, për te përpunuar zgjedhjet e veta, por fshihet mbas një përgjigje të menjëhershme dhe të sigurtë, shpesh medikamenteve, që duhet ti vënë kapakun zërit të vetë subjektit. Vështirësia për t'u përballuar me dëshirën, është një tjetër element që çon në një "tërmet", i cili nxjerr në sipërfaqe hijen e falimentimit dhe ngririjen e aktiviteteve (provime, lidhjet, shëndetin). Por falimentimi i përket Uni-t imagjinar. Nëpërmjet falimentimeve, pavetëdija bëhet e "dukshme", duke dhënë shënja se diçka nuk po shkon siç duhet. Ka diçka që është cënuar dhe e bën subjektin të vuajë. Të dëgjosh këtë dhimbje është e nevojshme dhe e domosdoshme, për të hapur rrugën e një fushe të re dijeje.
Eksperienca psiko-analitike më ka bërë të jem në kontakt gjithmonë me ekzistenca në kufi, rrugë të vështira jetë të bllokuara. Mahnitem çdo herë nga kurajo dhe dinjiteti që këta përsona venë në lëvizje për të kaluar momentet e errëta, por mbi të gjitha limitet e tyre. Sepse për kurajo bëhet fjalë. Të ngrihesh dhe të shkosh e të trokasësh në derën e një psikologu, nuk e është për të gjithë. Dëshirae shqyrtimit të situatave tona, të ndihmuar nga një profesionist dhe duke shqiptuar fjalët "Unë nuk mund ta bëj", nuk është për të gjithë.
Të zgjasësh dorën drejt Tjetrit, pa pritur që Tjetri të të thërrasë, është dinjitoze, është thjeshtësi është kurajo. Të ndalosh për të marrë frymë, në këto kohë që bluajnë ekzistenca, është vërtet revolucionare. Subjekti pretendon vendin e tij, nuk e lë veten të rrëshkasë, siç ndodh me objektet. Fillimisht dëgjoj ankesat, fajin ndaj Tjetrit, "shpirti i bukur" i Hegel që nuk dorëzohet. Më në fund, ndryshimi. "Pra, qenkam unë!" Shikimi qartësohet. Zëri ndryshon tonalitet. Dhe bota ndryshon prespektivën dhe ngjyrat e saj.

**Dr. Alketa Çoku**
Psikoterapeute

# EVENTI /

## TIRANË
FESTA E FËRGESËS – 12 KORRIK
LIQENI FARKËS / STAND UP PADDLE – 2 GUSHT

## DURRËS
FESTA E AKULLORES/ AKULLORE SI DIKUR
11-12 KORRIK

## KORÇË
KARNAVALET E KORÇËS – 8 QERSHOR
FESTA E VOSKOPJËS – 24 QERSHOR
FESTA E LAKRORIT – 3 GUSHT

## GJIROKASTËR
FESTA E LUNXHËRISË
15 GUSHT

## PËRMET
FESTA E VERËRAVE DHE FESTIVALI MULTIKULTUROR 2-15 QERSHOR

## HIMARË
KALA FEST – 12 – 19 QERSHOR
Për të dytin vit rradhazi, Himara mirëpret 5 ditë muzikë në bregdetin Jonian. KALA FEST organizohet nga artistë anglezë dhe mbështetet nga Bashkia Himarë.

ANJUNA DEEP FESTIVAL – 20-25 QERSHOR
Për here të parë organizohet në Himarë kjo festë 5 ditore.

## SARANDA
GARA E VELIERAVE
TE ZONËS SË JONIT 27-28 GUSHT

Festa në edicionin e saj të parë, me synimin që të transformohet në një traditë gjithëpërfshirëse. Eventi përfshin garimin e disa velierave, në zonën e Portit të Sarandës.

## VLORA
ULLIRI I BREGUT
28-29 KORRIK

## SHKODËR
ZÂ FESTIVAL THETH – 20-22 KORRIK
Në zonën malore dhe piktoreske të Thethit, organizohet "Zâ-Festival". Festival ka si qëllim promovimin dhe njohjen mes kulturave dhe traditave të ndryshme, përmes artit.

* Për info të mëtejshme, vizitoni faqen e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (www.mjedisi.gov.al)

# EVENTE

## TIRANA
FESTA CULINARIA – 12 LUGLIO
LAGO DI FARKA / STAND UP PADDLE – 2 AGOSTO

## DURAZZO
FESTA DEL GELATO TRADIZIONALE – 11-12 LUGLIO

## KORÇA
CARNEVALE DI KORÇA – 8 GIUGNO
FESTA DI VOSKOPJA – 24 GIUGNO
FESTA DEL LAKROR – 3 AGOSTO

## ARGIROCASTRO
FESTA DI LUNXHËRIA
15 AGOSTO

## PËRMET
FESTA DEL VINO E FESTIVAL MULTICULTURALE 2-15 GIUGNO

## HIMARA
KALA FEST – 12 – 19 GIUGNO
Per il secondo anno consecutivo, Himara accoglie 5 giorni di musica, sulla costiera ionica. KALA FEST è organizzato da artisti inglesi, con il patrocinio del Comune di Himara.

ANJUNA DEEP FESTIVAL – 20-25 GIUGNO
Per la prima volta a Himara, un festival house di 5 giorni.

## SARANDA
GARA DEI VELIERI DELLA COSTIERA IONICA - 27-28 AGOSTO

La festa nella sua prima edizione, ha l'obiettivo di trasformarsi in una tradizione inclusiva. L'evento prevede la regata di velieri, nella zona del Porto di Saranda.

## VALONA
FESTA DELL'ULIVO COSTIERO
28-29 LUGLIO

## SCUTARI
ZÂ FESTIVAL THETH – 20-22 LUGLIO
"ZÂ-Festival" è organizzato nella zona montagnosa e pittoresca di Theth. Il festival mira a promuovere e valorizzare gli scambi culturali e le tradizioni, attraverso l'arte.

* Per ulteriori informazioni, visitare il sito web del Ministero del Turismo e dell'Ambiente (www.mjedisi.gov.al)




Kompleksi Spitalor Universitar
"Zoja e Këshillit të Mirë"
Rruga Dritan Hoxha, Tiranë

| | |
|---|---|
| web | www.unizkm.al |
| Tel. | +355 4 2273 290 |
| email | info@unizkm.al |
| facebook | unikzkm |
| youtube | unikzkm |
| instagram | unikzkm/pontes_online |
| twitter | unikzkm |